



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva - Arhiva - Archive

Nr. Prot. 1138-9/23
Org. Jed. 02/MAP
Org. Unit
Nr. i faqeve 98
Broj stranica
No. pages:
Hyrëse
Data Datum 19.09.23
Date
PRISHTINË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

Për:	Ramiz Lladrovi , Kryetar i Komunës së Glllogocit
	Milaim Hajdari , Kryesues i Kuvendit të Komunës
Kopje:	Elbert Krasniqi , Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal
	Jeton Qela , Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
	Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes:	Resul Makreshi , Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve
	<i>per</i> Enis Spahiu , Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Nga:	Klit Shala , Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Zyrtarët përgjegjës:	
1. Zytari hartues i vlerësimit ligjor	Bora Duli , Zv. Udhëheqës e Divizionit për Hartim dhe Harmonizim të Legjislacionit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
2. Zytari konfirmues i vlerësimit ligjor	Kimete Zekaj , Zyrtare e Lartë për Politika Buxhetore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë të aktit të Komunës së Glllogocit
Lloji i aktit:	Vendim



I nderuari Kryetar z. Lladrovci,

I nderuari Kryesues z. Hajdari,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

Vendimi 02 Nr. 400-36513/23, për rritjen e të hyrave vetanake
Të miratuara më datë 27.07.2023
Të parashtruara për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 27.07.2023
Të dërguara për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 31.08.2023

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si “Ministria”), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërme të Komunës së Suharekës, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Komuna e Glogocit, me anë të aktit administrativ që është subjekt i shqyrtimit, synon ndryshimin e planit të buxhetit për të hyrat vetanake të vitit aktual fiskal, për shkak të rritjes së të hyrave vetanake gjatë vitit.
2. Për qëllime të këtij vlerësimi, është relevante të theksohet se proceset e mësipërme evidentohen edhe në legjislacionin që bie në fushëveprimin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, por duke mos u kufizuar në dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-21 (këtej e tutje referuar si “LMFPP”) dhe Ligjit Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023.
3. Kështu, në kuptim të ndarjeve buxhetore komunale, neni 6, paragrafi 2 i Ligjit të Buxhetit 2023 përcakton se në rast se shuma e të hyrave vetanake të Komunës gjatë vitit i kalojnë shumat e të hyrave të ndara të asaj komune ato balance janë në dispozicion për të financuar edhe projekte të reja ose ekzistuese në vitin aktual, si në vijim:

Neni 6
Ndarjet buxhetore komunale

2. Në rastet kur gjatë vitit fiskal shuma e të hyrave vetanake të një komune që janë depozituar në Fondin e Kosovës dhe regjistruar në SIMFK, kalojnë shumat e të hyrave të ndara në tabelën 4.1. të asaj komune, Thesari i Kosovës i raporton këto mjete si bilance në dispozicion të komunave përkatëse. Këto bilance janë në dispozicion për të financuar aktivitete dhe projekte të reja ose ekzistuese në vitin aktual, të aprovuara në përputhje me procedurat e përcaktuara në LMFP.
4. Nisur mbi premiset e këtij argumentimi, mbetet evidente se organizata ka bërë ndryshimin e planit të buxhetit për vitin 2023. Përkundër kësaj, realizimi i suksesshëm i një procesi të tillë karakterizohet me detaje teknike buxhetore për të cilat organizatat buxhetore bashkëpunojnë ngushtë me Departamentin e Buxhetit
5. Në këtë kuptim, Ministria konstaton se ligjërisht, Komunave ju mundësohet që këto bilance të përdoren për të financuar edhe projekte të reja dhe ekzistuese në vitin aktual, mirëpo realizimi i suksesshëm i tyre **kushtëzohet** me përputhshmërinë e materialeve përcjellëse të lendeve të proceduara nga Komuna në raport me udhëzimet dhe/apo rekomandimet e Departamentit të Buxhetit. Kjo nënkupton se vendimet e organizatave buxhetore mund të pësojnë ndryshime, konform rekomandimeve teknike të dhëna nga Departamenti i Buxhetit në Ministri.
6. Rrjedhimisht, **akti administrativ i Komunës së Glllogocit është në përputhje me legjislacionin në fuqi** - me kusht që Komuna të bashkëpunojë ngushtë dhe të veprojë sipas udhëzimeve dhe/apo rekomandimeve të Departamentit të Buxhetit.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Glllogocit dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministurskvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transferëve	
Kopje:	Kryetar i Komunës së Glllogocit Kryesuesi i KK – Glllogoc Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Jeton Qela, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 01.08.2023 VI- 020-615
Zyrtarët përgjegjës:		
1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Ministri të Linjës	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse	Vjosa Ahmetaj, Zyrtarë e Lartë për Monitorim të Komunave	
Lënda:	Shkresë përcjellëse në MPPT	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar: Vendimin 02 Nr. 400-36513/23, për rritjen e të hyrave vetanake, i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Glllogocit, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 3, të Rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendimin 02 Nr. 400-36513/23, për rritjen e të hyrave vetanake


I miratuar më datë: 27.07.2023

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 27.07.2023



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit (Gllëgoc)
Kuvendi i Komunës

02.Nr.400-36513 dt. 22.07.2023



Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës"), Ligjit Nr.08/L-193 Mbi Ndarjet Buxhetore Për Buxhetin e Republikës së Kosovës; Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë: 27.7.2023, miratoi këtë:

VENDIM
PËR RRIJTJEN E TË HYRAVE VETANAKE

Neni 1

Me këtë vendim, miratohet rritja e të hyrave vetanake për vitin 2023 kundrejt të hyrave vetanake të ndara në tabelën 4.1. për vitin fiskal 2023.

Neni 2

Të hyrat vetanake rritën në shumë prej 849,910.00 euro kështu që buxheti nga të hyrat vetanake të planifikuara për vitin 2023 nga 1,357,468.00 euro rritet në shumën 2,207,378.00 euro.

Neni 3

Mjetet financiare nga neni 2 i këtij vendimi destinohen si vijon:

Në kategorinë e shpenzimeve Kapitale në nën programet dhe projektet:

Infrastruktura Publike (18161) në projektet:

"Ndërtimi, zgjerimi dhe rekonstruimi i rrugëve të asfaltuara në Drenas, kodë (53660) në vlerë prej: 347,000.00 €
"Asfaltimi i rrugëve dhe kubzimi Drenasin I, II, III dhe IV", kodë (53645) në vlerë prej: 375,000.00 €
"Rregullimi i trotuarve dhe ndriqimi publik, Drenas, Komoran, Arllat, Terstenik, Dobroshevc dhe Baicë, kodë (53635) në vlerë prej: 100,000.00 €
Shërbime Kulturore (85001)
"Ndërtimi i parkingut, rrethoja, fusha sintetike në Drenas", kodë (53738) 4,910.00 €
Administrata (16301)
"Vetura zyrtare "(projekt i ri) 23,000.00 €

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Web faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatese;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari

Arsyetim:

Konform ligjit të buxhetit nr. 08/L-193 për vitin fiskal 2023 neni 6, pika 2.

Në rastet kur gjatë vitit fiskal shuma e të hyrave vetanake të një komune që janë depozituar në Fondin e Kosovës dhe regjistruar në SIMFK, kalojnë shumat e të hyrave të ndara në tabelën 4.1. të asaj komune, këto bilance janë në dispozicion për të financuar aktivitete dhe projekte të reja ose ekzistuese në vitin aktual, të aprovuara në përputhje me procedurat e përcaktuara në LMFP.

Projekti Nr.53660, me këtë projekt parashihet zgjerimi dhe ndërtimi i shiriti ndihënës përgjat rrugës regjionale R102 që do të ndikoj në lirin e qarkullimit në hyrjen e qytetit, përkatsisht tek rreth rrotullimit.

Projekti, 53465 Asfaltimi dhe kubizimi në Drenas I, II, III dhe IV është projekt që përfshin zonën e qendrës si dhe një zonë të gjerë të qytetit dhe investimet janë të domosdoshme në rregullimin e infrastrukturës në gjithë zonën. Buxheti aktual është i pamjaftueshëm andaj me këtë financim shtesë përmbushen nevojat dhe kërkesat e qytetarëve në masë të konsiderueshme.

Projekti 53635, Ndërtimi Publik janë kërkesa të shumta të qytetarëve për të investuar në këtë infrastrukturë dhe me buxhetin aktual është e pa mundur të përmbushen kërkesat andaj kërkohet financim shtesë.

Projekti 53738, Ndërtimi i parkingut, rrethoja, fusha sintetike në Drenas me këtë financim do të përmbyllen obligimet dhe përfundon ky projekt.

Projekti "Vetura zyrtare" (projekt i ri) blerja e veturave zyrtare për nevoja e Institucionit meqë veturat aktuale janë tëjetë të amortizuara.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr. 400/01-36210 dt. 26.072023

Në bazë të nenit 58, paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit. Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës"), Ligjit Nr.08/L-193 Mbi Ndarjet Buxhetore Për Buxhetin e Republikës së Kosovës; Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2023, të aprovojë këtë:

**PROPOZIM VENDIM
PËR RRITJEN E TË HYRAVE VETANAKE**

Neni 1

Me këtë Propozim vendim, miratohet rritja e të hyrave vetanake për vitin 2023 kundrejt të hyrave vetanake të ndara në tabelën 4.1. për vitin fiskal 2023.

Neni 2

Të hyrat vetanake rriten në shumë prej 849,910.00 euro kështu që buxheti nga të hyrat vetanake të planifikuara për vitin 2023 nga 1,357,468.00 euro rritet në shumën 2,207,378.00 euro.

Neni 3

Mjetet financiare nga neni 2 i këtijë vendimi destinohen si vijon:

Në kategorinë e shpenzimeve Kapitale në nën programet dhe projektet:

Infrastruktura Publike (18161) në projektet:

"Ndërtimi, zgjerimi dhe rekonstruimi i rrugëve të asfaltuara në Drenas, kodi (53660) në vlerë prej: 347,000.00 €
"Asfaltimi i rrugëve dhe kubzimi Drenasin I, II, III dhe IV", kodi (53645) në vlerë prej: 375,000.00 €
"Rregullimi i trotuarve dhe ndriçimit publik, Drenas, Komoran, Arllat, Terstenik, Dobrosheve dhe Baicë, kodi (53635) në vlerë prej: 100,000.00 €

Shërbime Kulturore (85001)

"Ndërtimi i parkingut, rrethoja, fusha sintetike në Drenas", kodi (53738) 4,910.00 €

Administrata (16301)

"Vetura zyrtare" (projekt i ri) 23,000.00 €

[Signature]

Arsyetimi:

Komfor ligjit të buxhetit nr. 08/L-193 për vitin fiskal 2023 neni 6, pikë 2.

Në rastet kur gjatë vitit fiskal shuma e të hyrave vetanake të një komune që janë depozituar në Fondin e Kosovës dhe regjistruar në SIMFK, kalojnë shumat e të hyrave të ndara në tabelën 4.1. të asaj komune, këto bilance janë në dispozicion për të financuar aktivitetet dhe projekte të reja ose ekzistuese në vitin aktual, të aprovuara në përputhje me procedurat e përcaktuara në LMFP.

Projekti Nr.53660, me këtë projekt parashihet zgjerimi dhe ndërtimi i shiritit ndihënës përgjat rrugës regjionale R102 që do të ndikoj në lirin e qarkullimit në hyrjen e qytetit, përkatsisht tek rreth rrotullimit.

Projekti, 53465 Asfaltimi dhe kubizimi në Drenas I,II,III dhe IV është projekt që përfshin zonën e qendrës si dhe një zonë të gjerë të qytetit dhe investimet janë të domosdoshme në rregullimin e infrastrukturës në gjithë zonën. Buxheti aktual është i pamjaftueshëm andaj me këtë financim shtesë përmbushen nevojat dhe kërkesat e qytetarëve në masë të konsiderueshme.

Projekti 53635, Ndriqimi Publik janë kërkesa të shumta të qytetarëve për të investuar në këtë infrastrukturë dhe me buxhetin aktual është e pa mundur të përmbushen kërkesat andaj kërkohet financim shtesë.

Projekti 53738, Ndërtimi i parkingut, rrethoja, fusha sintetike në Drenas me këtë financim do të përmbillen obligimet dhe përfundon ky projekt.

Projekti "Vetura zyrtare "(projekt i ri) blerja e veturave zyrtare për nevoja e Institucionit meqë veturat aktuale janë tëjetë të amortizuara.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovi